



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:297040

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747192

KPPP.nr. 2236/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “EuroPlus” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811167156 dhe me seli në Hani i Elezit, rr. “Veli Balazhi”, kundër debitorit “ALBA GROUP” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810829864 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Musa Tolaj”, Lam A, hyrja 1, kati 4, nr. 3, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Jupolli & Associates” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 633/23 i datës 06.12.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu nga Ferizaj, jashtë seancës me datën 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “ALBA GROUP” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 633/23 i datës 06.12.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “EuroPlus” Sh.P.K., me datë 06.12.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 633/23, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 22-SHV04-001-58, e datës 12.07.2022; Faturës nr. 22-SHV04-001-59, e datës 13.07.2022; Faturës nr. 22-SHV04-001-64, e datës 22.08.2022; Faturës nr. 22-SHV04-001-67, e datës 19.09.2022; Faturës nr. 23-SHV04-001-12, e datës 15.02.2023 dhe Faturës nr. 23-SHV04-001-58, e datës 05.09.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,412.80 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e kalimit

të afatit për pagesë e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përbarimor janë në shumën totale prej 3087.80 €, e që është dyfishi i shumës së kërkuar në propozimin për përbarim. Ka shtuar se shumica e faturave janë paguar, si dhe faturat nuk i përmbajnë kushtet e kërkuara sipas nenit 27 të LPP-së, për faktin se koha e përmbushjes së kredisë është në ditën e njëjtë të lëshimit të faturës. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se borxhi rrjedh nga faturat e cekura në propozimin për përbarim, e të cilat nuk janë paguar nga debitori. Ka shtuar se të njëjtat i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për përbarim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 22-SHV04-001-58 e datës 12.07.2022; Fatura nr. 22-SHV04-001-59 e datës 13.07.2022; Fatura nr. 22-SHV04-001-64 e datës 22.08.2022; Fatura nr. 22-SHV04-001-67 e datës 19.09.2022; Fatura nr. 23-SHV04-001-12 e datës 15.02.2023 dhe Fatura nr. 23-SHV04-001-58, e datës 05.09.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 29 par. 3 të

LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në fatura, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim lidhur me të metat e dokumenteve mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme pasi që debitori, nuk ka ofruar asnjë provë siç kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP-së, për të provuar ekzistimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, andaj në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2236/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.